

L I G J
Nr.7524, datë 19.11.1991

PËR STATUSIN E RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese".

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH) është institucion qendror informativ e kulturor shtetëror, mbarëkombëtar, që udhëhiqet nga idealet kombëtare.

Neni 2

RTSH është në varësinë dhe kontrollin e Kuvendit Popullor

Neni 3

RTSH është institucion i depolitizuar, ku ndalohet veprimtaria e partive politike. Drejtuesve dhe punonjësve të RTSH u ndalohet anëtarësia në parti si dhe zhvillimi i veprimtarive politike në favor ose kundër cilësdo forcë politike e shoqërore.

Neni 4

Ndalohet ndërhyrja e partive dhe e organizatave të ndryshme në veprimtarinë e RTSH.

Neni 5

Programet e RTSH bazohen në parimet e demokracisë, pluraliste, të panashmërisë dhe të objektivitetit. Ato mbrojnë e zhvillojnë traditat dhe kulturën kombëtare.

RTSH nuk duhet t'u shërbejë në mënyrë të njëanëshme interesave të asnjë partie, organizate apo force shoqërore.

Neni 6

Ndalohet përhapja e njoftimeve, që përbëjnë sekret shtetëror të njohur me ligj, që bëjnë thirrje për përmbysjen me dhunë të rendit kushtetues, për luftë e terror, për të nxitur armiqësitë politike, etnike e fetare në shoqëri dhe çdo veprimtari tjetër që bie në kundërshtim me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

RTSH drejtorhet nga Këshilli drejtues, në përbërjen e të cilit bëjnë pjesë specialistë të shquar nga fusha të ndryshme të jetës së vendit. Këshilli Drejtues propozohet nga Komisioni i Përhershëm i Mjeteve të Informacionit Masiv të Kuvendit Popullor dhe miratohet nga Kuvendi Popullor.

Neni 8

Këshilli drejtues i RTSH është organ vendimor. Ai përbëhet nga 17 veta. Anëtarë të Këshillit

janë edhe Drejtori i Përgjithshëm i RTSH, zëvendësi i tij, drejtori i Radios së Brendëshme, drejtori i Radios së Jashtëme dhe drejtori i Televizionit.

Në çdo dy vjet Këshilli Drejtues përtërihet deri në 1% të anëtarëve të tij të jashtëm.

Neni 9

Këshilli Drejtues i RTSH:

- miraton strukturën organizative, platformën e programeve dhe rregulloren e veprimtarisë së informacionit;

- kontrollon zbatimin e ligjshmërisë në fushën e transmetimeve radiotelevizive;

- gjykon për panshmërinë, objektivitetin dhe tërësinë e informacionit radioteleviziv;

- zgjedh nga gjiri i tij me votim të fshehtë Drejtorin e Përgjithshëm të RTSH;

- me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm miraton zëvendësdrejtorin e përgjithshëm të RTSH, drejtorin e Televizionit, të Radios së Brendëshme e të Jashtëme;

- miraton kriteret kryesore për marrjen në punë pagesën dhe shpërblimin e punonjësve;

- miraton ndarjen e fondeve të institucionit dhe kontrollon zbatimin e tij;

- mbron të drejtën morale dhe materiale të autorit.

Neni 10

Anëtarët e jashtëm të Këshillit marrin shpërblim mujor. Masa e këtij shpërblimi caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 11

Drejtori i Përgjithshëm i RTSH:

- drejton veprimtarinë e institucionit për zbatimin e platformës programore, organizative e financiare të tij;

- drejton mbledhjet e Këshillit Drejtues të RTSH dhe sugjeron tematikën e mbledhjeve;

- emëron dhe shkarkon të gjithë vartësit e tij, me përjashtim të drejtuesve të përcaktuar në nenin 8.

Neni 12

RTSH është person juridik që përfaqësohet nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH.

Neni 13

RTSH është institucion buxhetor që financohet nga shteti. Burim mjetesh financiare janë edhe veprimtari të tjera të njohura me ligj.

Neni 14

Ndalohet shndërrimi i RTSH në një qendër thjesht komerciale.

Neni 15

Dispozitat ligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 16

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.77, datë 23.11.1991 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Ramiz Alia.

